

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 3

Kodi: 079

SHKATHTËSITË PËR ZHVILLIM PERSONAL

Tipi i programit: Plotësues

Hyrje

Programi “Shkathtësitë për zhvillim personal - PEACOCK” është rezultat i punës disavjeçare që është bërë në kuadër të projekteve FACE-PEACOCK e që për qëllim ka mbështetjen e bashkëjetesës paqësore të të gjitha grupeve etnike në Kosovë, përmes prezantimit të programit mësimor për zhvillimin personal. Projekti është përkrahur nga Fakulteti i Mësuesisë në Cyrih PHZH. Nga vitin 2020 është punuar në krijimin dhe përkthimin e udhëzuesve për zhvillim personal - FACE për klasat 1-5 si dhe për zhvillim personal - PEACOCK për klasa 6-9 të përshtatura sipas kërkesave të Kurrikulës Kombëtare të Kosovës. Në këtë proces është përfshirë edhe Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës, i cili ka përfshirë elemente të zhvillimit personal dhe zhvillimit të karrierës në lëndë të ndryshme. Udhëzuesit u dedikohen mësimdhënësve të cilët përkrahin tek nxënësit e tyre shkathtësitë për jetë dhe ato ndërlidhëse për zhvillim të karrierës. Udhëzuesit fokusohen në mënyrat si të mësohen shkathtësitë ndërlidhëse që janë të nevojshme për zhvillimin e nxënësve të shëndetshëm në aspekt fizik dhe mental dhe e përkrahin zhvillimin e identitetit të tyre personal.

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë gjendje:

- Të kuptojnë çfarë janë shkathtësitë për zhvillim personal;
- Të kuptojnë se shkathtësitë për zhvillim personal janë pjesë përbërëse e shkollës dhe jetës;
- Të përvetësojnë teknika dhe metoda për të prezantuar shkathtësitë personale sipas udhëzuesve përkatës;
- Të jenë të gatshëm të shfrytëzojnë materialet online;
- Të jenë të gatshëm për të shpërndarë dijet dhe informacionet edhe tek palët e treta.

Përmbajtja e trajnimit

Edukimi për zhvillim personal dhe shkathtësi për jetë është i përfshirë në të gjitha lëndët shkollore dhe gjithmonë është i ndërlidhur me përmbajtjen mësimore që është relevante për individin në gjendjen e tij momentale të zhvillimit. Përmbajtja dhe detyrat në këtë program janë dizajnuar dhe synojnë grupmosha dhe klasa të ndryshme, nga klasa parafillore deri tek klasa e 9-të.

Përgjatë viteve të shkollimit të obligueshëm, mësimi i shkathtësive për jetë bëhet gjithnjë e më kompleks, duke përcjellë tema të ngjashme çdo vit, si dhe duke u fokusuar në të njëjtat shkathtësi gjatë gjithë kohës në shkollë.

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 3

Në këtë program për zhvillim personal, shkathtësitë për jetë mësohen në një rend prej pesë modulesh të cilat përfshijnë konceptet kryesore si në vijim:

Moduli 1 “Arti i vetënjohtës dhe i njohjes së të tjerëve” thekson vetënjohtësin dhe vetëbesimin, hulumtimin dhe vetëvlerësimin e burimeve personale, familjen si vlerë, përgjegjësitë, rolet gjinore dhe stereotipat, komunikimin me vendosmëri, pa konflikt dhe pa dhunë, vullnetarizmin, etj.;

Moduli 2 “Sigurimi i cilësisë së jetës”, përqendrohet në integritetin, menaxhimin efikas të burimeve, përgjegjësinë për zhvillim të qëndrueshëm, menaxhimin e mirë të vetes, etj.;

Moduli 3 “Stilet e jetës së shëndetshme” i udhëzon nxënësit për çështje që lidhen me shëndetin fizik dhe emocional, ushqimin e shëndetshëm, parandalimin e përdorimit të drogës, alkoolit dhe duhanit, ndikimin gjinor, etj.;

Moduli 4 “Dizajnimi i karrierës personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse” thekson të kuptuarit e profesioneve nga perspektiva e tregut të punës, planifikimin e karrierës dhe vendimmarrjen në lidhje me karrierën, ndërmarrësinë si një mundësi karriere etj.;

Moduli 5 “Siguria personale” i pajis nxënësit me njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që i ndihmojnë të kujdesen për sigurinë e tyre dhe të të tjerëve.

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet mësimdhënësve, studentëve, pedagogëve, udhëheqësve të shkollave dhe profesorëve universitarë.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi realizohet me prezencë fizike për dy ditë pune, ku pjesëmarrësit pas përmbajtjes së trajnimit kanë mundësi të njoftohen me doracakët të cilët janë online. Pas trajnimit pjesëmarrësit obligohen të realizojnë së paku tre aktivitete të cilat të dokumentohen tek trajnerët.

Për të plotësuar informatat e marra në trajnim, pjesëmarrësit kanë mundësi të ndjekin edhe trajnimin online. Pjesëmarrësi e ndjek dinamikën individuale të të nxënësit duke lundruar në programin e trajnimit. Pjesë të përmbajtjes së programit të trajnimit mbështeten me prezantime me PPT dhe video-inçizime si dhe udhëzuesit elektronikë që mundësojnë lexim më të thelluar për përmbajtjet e caktuara.

Certifikimi

Në fund të këtij programi të trajnimit pjesëmarrësit do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 20 orë trajnimi (12 orë trajnim të drejtpërdrejtë si dhe 8 orë zhvillim përmes punës në shkollë).

Kriteret për certifikim janë:

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 3

- Pjesëmarrja aktive në së paku 90% të kohëzgjatjes së trajnimit; dhe
- Dokumentimi i punës praktike në klasë: Si dëshmi për përmbushjen e obligimeve në klasë, pjesëmarrësit duhet të dorëzojnë planet e punës dhe dëshmitë për realizimin e së paku tri aktiviteteve me nxënës, brenda tri javëve pas përfundimit të trajnimit.

Materialet e trajnimit

1. Udhëzuesit për shkathtësitë për jetë <https://ipe-textbooks.phzh.ch/de/albanien/>
2. Modulet online <https://kec-elearning.org/peacock>